



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2020:186416

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05442035

**C.nr.379/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA SKENDERAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, i përbërë nga gjyqtari Hajrullah Aruqi, në çështjen juridike të paditësve F.X. dhe E.X., te dy nga fshati..., komuna Skenderaj, të cilët i përfaqëson me autorizim Xh.B., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës K... “Siguria” me seli në Prishtinë, për kompensim dëmi, pas mbajtjes se seancës për shqyrtim kryesor me datë 27.12.2023 me pjesëmarrjen e palës paditëse dhe pa praninë e të paditurës, me datë 10.01.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve F.X. dhe E.X. te dy nga fshati..., komuna Skenderaj.

**DETYROHET** e paditura K... “Siguria” me seli ne Prishtinë qe paditësve F. dhe E.X. ne emër te dëmit qe e kanë pësuar ne aksidentin e trafikut me dt.21.06.2020 qe ka ndodhë në rrugën Rajonale Skenderaj – Vushtrri, në fshatin... afër Pompës së Derivateve “K...”, me fajin e vetëm te të siguruarit te të paditurës te iu kompensoj dëmin në shumat si në vijim:

**Për paditësin F.X.**

**Dëmi jo material:**

Për dhimbjet fizike trupore shumë prej 1,500 euro;

Për friken e përjetuar shumë prej 1,300 euro;

Për dhimbjet shpirtërore, për shënim te lehtë trupor shumë prej 1,400 euro;

**Dëmi material:**

Për ndihmën dhe kujdesin e huaj shumë prej 150 euro;

Për ushqimin e përforcuar shumë prej 140 euro;

Gjithsejtë në shumë prej 4,490 euro (katërmijë e katërqind e nëntëdhjetë) euro.

**Për paditësin E.X.**

**Dëmi jo material:**

Për dhimbjet fizike trupore, shumen prej 2,300;

Për friken e përjetuar, shumen prej 1,500 euro;

Për dhimbjet shpirtërore, për ZAJ ne shkallën prej 3%, shumë prej 1,500 euro;

**Dëmi material:**

Për ndihmën dhe kujdesin e huaj, shumën prej 200 euro;  
Për ushqimin e përforcuar, shumën prej 200 euro;  
Për demin material te pësuar ne automjet te tipit Xhip Suzuki me targa te regjistrimit... shumen prej 3,159 euro;  
Gjithsejtë shumën prej 8,859 (tetëmijë e tetëqind e pesëdhjete e nëntë) euro.

Detyrohet e paditura qe te paguaj shumen e përgjithshme për dy paditësit prej 13,349.00 (trembëdhjetë mijë e treqind e katërdhjetë e nëntë) euro, me kamatë ligjore ne normën prej 8%, për demin jo material nga dita e aktgjykimit me datë 10.01.2024 ndërsa për demin material nga dita e shkaktimit te dëmit me datë 21.06.2020.

**OBLIGOHET** e paditura që paditësve tu kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë 312 euro për padi, 41 takse për padi, 300 euro për ekspertize te komunikacionit dhe makinerisë, 600 euro për ekspertiza mjekësorë, për 5 përfaqësime ne seanca nga 405 euro, gjithsej shumën prej 2,025 euro, për precizim te padisë 312 euro, gjithsejtë në shumën 3,590 euro.

Te gjitha shumat e gjykuara duhet te paguhen ne afat prej 15 dite nga dita e marrjes se këtij aktgjykimi.

**REFUZOHET** si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë për te dy paditësit mbi shumat e gjykuara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi ngase shumat e kërkuara janë te larta ne raport ne demin qe e kanë pësuar paditësit.

### Arsyetim

Paditësit ne padinë e ushtruar ne gjykate kanë theksuar se e paditura K...“Siguria” mbanë përgjegjësi për demin nga auto përgjegjësia, sepse me datë 21.06.2020, është shkaktuar aksident i komunikacionit ku lëndime trupore kane pësuar paditësit. Aksidenti i komunikacionit ka ndodhe nga pakujdesia e ngasësit A me mbulese siguruese te K...“Siguria” ku drejtuesi i automjetit nga pa kujdesia gjatë drejtimit në kundërshtim me Ligjin mbi Sigurinë ne Komunikacionin Rrugor ka shkaktuar aksident ku paditësve iu kane shkaktuar lëndime trupore – dem material dhe jo material. Paditësit F.X. dhe E.X. pas aksidenti janë transportuar dhe kanë marre ndihme mjekësore ne Spitalin Regjional te Mitrovicës, ndërsa E.X. ne QKUK ne Klinikën e Neurologjisë në Prishtinë. Për ketë paditësit i kanë bashkangjitur padisë raportet mjekësore. Paditësi E.X. ka pësuar edhe dem material te veturën tij te tipi Jeep Suzuki....

I propozuan gjykatës qe te caktohet seanca përgatitore ne te cilën përmes përfaqësuesit me autorizim mbeten pranë kërkesëpadisë duke kërkuar nga gjykata nxjerrjen e provës me ekspertizë te komunikacionit për te konstatuar rrethanat dhe faktorët qe kanë ndikuar në shkaktimin e aksidentit, nxjerrjen e provës me ekspertize mjekësore nga ekspertet N.H. – neurolog dhe G.H. psikiatër si dhe nxjerrjen e provës me ekspertize te makinerisë për vlerësim te dëmit ne automjet.

Pas nxjerrjes se provave ne ekspertiza mjekësore dhe plotësimin e ekspertizës nga eksperti mjekësor Dr. N.H. neurolog paditësit përmes përfaqësuesit me autorizim me parashtrere te datës 06.12.2023 e precizuan kërkesëpadinë ashtu qe për paditësin F.X. i cili ka pësuar lëndime te lehta trupore për dhimbjet fizike kërkoj shumën prej 2,500 euro, për shëmtim trupor shumën prej 2,000 euro, për friken e përjetuar shumën prej 2,000 euro, për ndihmën e huaj shumen 280 euro, dhe për ushqimin e përforcuar shumën prej 280 euro. Për paditësin E.X. qe ka pësuar lëndime te

rënda trupore, kërkoj shumën prej 4,000 euro, për ZAJ te shprehura ne shkallë prej 3% shumën prej 2,000 euro, për frikën e përjetuar shumën prej 3,500 euro, për ndihmën e huaj shumën prej 400 euro, për ushqimin e përforcuar shumën prej 400 euro dhe për dëmin ne automjetin markës Jeep SUZUKI me targa..., shumën prej 3,159 euro, ashtu qe shumat e kërkuara i propozoj gjykatës qe te aprovohen me kamatë ligjore ne normën prej 8%, për dëmin jo material nga dita e nxjerrjes se aktgjykimit ndërsa për dëmin material nga dita e shkakimit te demit me date 21.06.2020.

I kërkoj shpenzimet e procedurës kontestimore ne shumen prej 3,590 .

E paditura me përgjigje ne padi te dt.25.05.2023, është deklaruar se e ka pranuar aktvendimin nga gjykata për dhënien e përgjegjës ne padi por edhe ne procedurën administrative nga paditësit ka pranuar kërkesë për kompensim te demit dhe është kërkuar nga paditësit qe ti sjellin dokumentacionin e nevojshëm ne origjinal ose te noterizuara qe nuk e kanë sjellë dhe për ketë arsye nuk janë deklaruar për bazën ligjore dhe lartësinë e kërkesëpadisë.

Gjate shqyrtimit përgatitor u deklaruan se mbeten pranë përgjegjës ne padi, edhe me tutje ne mungese te provave mbetet kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë. Nuk kundërshtuan nxjerrjen e provave me ekspertize te komunikacionit dhe te makinerisë nga eksperti S.B. dhe nxjerrjen e provës me ekspertize mjekësore nga ekspertet Dr.N.H. neurolog dhe Dr.G.H. psikiatër.

Ne seancën e shqyrtimit kryesor me dt.16.10.2023 u deklaruan se nuk kanë vërejtjeje ne ekspertizën e komunikacionit, sa i përket ekspertizës se makinerisë kanë vërejtje vetëm ne lartësinë e saj por nuk kërkuan sqarime nga eksperti ne seance gjyqësore. Për sa i përket ekspertizës mjekësore te dhëne nga ekspertet e përmendur me larte kërkuan qe te iu jepet mundësia qe pas konsultimit me ekspertet e kompanisë te deklarohen ne seancën e ardhshme. Nuk kundërshtuan propozimin e palës paditëse qe ne seancën e radhës te merr pjese eksperti mjekësore Dr. N.H. neurolog për te deklaruar për natyrën e lëndimeve trupore për paditësin E.X. Ne seancën vijuese te dt.27.11.2023, ku morri pjese eksperti mjekësor dhe sqaroi se paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore e paditura nuk morri pjese ne seance dhe deri ne përfundim te shqyrtimit kryesor nuk janë deklaruar me ndonjë parashtrese për sa i përket ekspertizave mjekësore, kështu që gjykata vlerëson se edhe për të paditurën mendimet dhe konstatimet e eksperteve mjekësor të të dhëna me shkrim që e paditura i ka pranuar me kohë me dt. 11.10.2023 janë të pranueshme.

Gjykata me qellim te konstatimit te drejte dhe te plote te gjendjes faktike ne çështjen konkrete juridike ne kuptim te nenit 7dhe 8 te LPK-së i nxori dhe i administroi te gjitha provat e shënuara ne procesverbalin e seancës se shqyrtimit kryesor me dt.28.12.2023, një nga një dhe te gjitha se bashku duke i krahasuar njërën me tjetrën nga te cilat rezulton se kërkesëpadija e paditësve është pjesërisht e bazuar .

Për sa i përket rrethanave dhe faktorëve qe kanë ndikuar ne aksidentin e komunikacionit qe ka ndodhur me dt.21.06.2020 rreth orës 10:25 minuta ne Rrugën regjionale Skenderaj-Vushtri sipas përshkrimit ne referat te padisë dhe raport te aksidentit e kanë nxjerrë provën me ekspertize te komunikacionit nga eksperti S.B. i cili me dt.29.06.2023, gjykatës i ka dorëzuar mendimin dhe konstatimin ne forme te shkruar.

Sipas ekspertit aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me dt.21.06.2020 rreth orës 10:25 ne Rrugën Skenderaj-Vushtri afër pompës se derivateve “K...” ne fshatin...

Ne aksident te komunikacioni janë përfshire automjeti i klasifikuar sipas ekspertit A i tipi Vw-Golf4 me targa te regjistrimit... i siguruar te K... “S...” te cilin e ka drejtuar N.H. Automjeti tjetër

i përfshirë në këtë aksident B i Tipit Suzuki Jeep (SI 410, Smurati), me targa të regjistrimit... pa sigurim që e ka drejtuar E.X. nga fshati...

Eksperti pas analizimit dhe vlerësimit të provave të siguruara nga vendi i ngjarjes gjurmët në rrugë teknike dhe biologjike, rrjedhjen e ngjarjes të përshkruar në raportin e aksidentit të policisë konstatoi se të dy ngasësit e automjeteve "A-B" ishin duke lëvizur në rrugën regjionale Skenderaj-Vushtrri nga drejtimi Skenderaj në drejtim të Vushtrrisë. Automjeti "A" e ka përplasur nga mbrapa automjeti "B" i cili ishte duke lëvizur. Pika e kontaktit është në shiritin e djathtë të komunikacionit, shikuar në drejtimin e automjeteve.

Sipas ekspertit pasi që në dokumentacionin e ofruar nga policia gjendet informata për gjurmët teknike – është e mundur të gjendet shpejtësia e përafërt e automjeteve. Prandaj sipas analizave në përgjithësi, duke shfrytëzuar literaturën dhe Softweret përkatës, duke analizuar pozitat përfundimtare të automjeteve pas aksidentit duke marrë parasysh dëmtimet nga fotot dhe video incizimet konstatoi se shpejtësia ka qenë rreth ( $V_{ao}=80\text{km/h}$  dhe  $V_{80}=30\text{km/h}$ ).

Eksperti mbi bazën e fakteve dhe provave të analizuara dhe vlerësuara që u përmenden më lartë ka dhënë mendim dhe konstatim se drejtuesi i automjetit "A" nuk ju ka përmbajtur ligjit dhe rregullave të trafikut rrugor nr.05/L-088. Drejtuesi i automjetit është i detyruar të mbajë distancën e sigurisë kur lëviz pas mjetit tjetër duke pasur parasysh shpejtësinë e lëvizjes, gjendjen, llojin dhe fushe pamjen e rrugës, dukshmërinë, kushtet atmosferike, gjendjen e ngarkesës, gjendjen e vet psikofizike dhe gjendjen e sistemit frenues.

Në bazë të provave të analizuara dhe videos vërehet se ngasësi "A" nuk e ka ngadalësuar shpejtësinë nga formula  $ds=1\_2.v(m)$ , si dhe nga moskujdesi në ngasje. Në video vërehet se ngasësi "A" nuk e ka ngadalësuar shpejtësinë dhe ka pasur për qëllim tejkalimin e automjetit "B", por nga kahu i kundërt ka ardhur një automjet tjetër, dhe ngasësi "A" e ka përplasur mbrapa automjetin "B".

Ngasësi i automjetit "A" sipas video incizimit e ka tejkaluar shpejtësinë e lëvizjes në vendbanim ( $v/50$ ) duke mos përshtat shpejtësinë e lëvizjes në komunikacion në mënyrë që mjetin ta ndal nga çdo pengesë.

Ngasësi i automjetit "B" ka qarkulluar në shiritin e tij të komunikacionit dhe është përplas mbrapa dhe konstatoj se ky ngasës "B" nuk ka dhënë kontribut të aksidentit, ndërsa drejtuesi i automjetit "A" është shkaktar i aksidentit.

Palët ndërgjyqëse nuk e kontestuan ekspertizën e komunikacionit.

Gjykata e vlerësoi ekspertizën e komunikacionit të cilën e mori si prove të besueshme ngase i përmban të gjitha elementet e nevojshme, të dhëna mbi bazën e përvojës dhe njohurive të ekspertit i cili me argumente profesionale dhe shkencore e ka ndriçuar gjendjen faktike duke konstatuar se i siguruari i të paditurës është fajtor i vetëm në shkaktimin e aksidentit të trafikut, prandaj gjykata e morri si prove vendimtare për bazën juridike të kërkesëpëdisë.

Pas konstatimit se i siguruari i të paditurës është fajtor i vetëm për shkaktim të aksidentit të komunikacionit, gjykata e ka nxjerr provën me ekspertizë mjekësore nga ekspertet Dr. N.H. neurolog dhe Dr.G.H. psikiatër, për konstatim të natyrës së lëndimeve trupore dhe dëmin që kanë pësuar paditësit në aksident komunikacioni.

Me propozimin e palëve ndërgjyqëse paditësit janë ekzaminuar në QKUK në Prishtinë dhe ekspertet mjekësore gjykatës mendimin dhe konstatimin me shkrim ia kanë dorëzuar gjykatës me dt.11.10.2021 dhe me 16.10.2023.

Sipas ekspertit mjekësor Dr. N.H. neurolog pas vlerësimit të raporteve mjekësore të evidentuara në ekspertizë dhe ekzaminimit të drejtpërdrejt të paditësit F.X. në aksidentin e komunikacionit

ka pësuar këto lëndime trupore: gjendje post traumës, shtypjes te kokës, shtypje te gjoksit T/c te djathte, dhe shtypje te gjoksit anës se majte, plage ne vetullën e majte dhe ne mollëzën e faqes se majtë. Këto lëndime janë konsideruar te natyrës se lehtë trupore.

Si pasojë e lëndimeve paditësi ka pësuar dhimbje fizike ne momentin e lëndimit si dhe gjatë intervenimit mjekësore, gjegjësisht gjate pushimit mjekësore i cili ka pasur dhimbje fizike te intensitetit jashtëzakonisht te larta kanë zgjat 30 minuta dhe janë dhimbje qe manifestohen nga momenti i aksidentit derisa paditësi ka arritur ne QE dhe është ordinar terapia adekuate kundër dhimbjeve. Dhimbjet e intensitetit te larte kanë zgjatur 5 dite te cilat janë manifestuar si pasoje e lëndimit ne koke shtypje ne regjionin e kokës qe manifestohet me dhimbje te kokës dhe marramendje. Dhimbje te intensitetit te mesëm kanë zgjatur 4 jave kohe pas kohe derisa ka marrë terapi. Dhimbje te intensitetit te lehtë janë kronike prezentë edhe tutje.

Gjykata duke marr për baze mendimin dhe konstatimin e ekspertit i cili konstatoi shkallen , intensitetit dhe kohëzgjatjet e dhimbjeve fizike e aprovoi shume prej 1400 euro.

Sipas ekspertit paditësi ka pësuar shëmtim trupor te shkalles se ulet ku vërehet cikatrix ne vetullën e majte dhe ne mollëzën ne faqen e djathtë.

Dukë marrë për bazë faktin se shëmtimi është i shkallës së ulët por në pjesën e dukshme të fytyrës, moshën e re të paditësit, gjykata e aprovoi shumen prej 1400 euro e cila është ne pajtueshmëri me këtë formë te demit.

Paditësi F.X. si pasoje e aksidentit dhe lëndimeve te pësuar ne këtë aksident ka përjetuar frike sekondare te intensitetit te larte nga momenti i goditjes se automjetit mbrapa, ardhja e ndihmës se par dhe dërgimi ne QKMF ne Skenderaj dhe dërgimi për ndihme QE ne Mitrovicë për diagnostikim dhe rëntgen dhe ekzaminimet tjera i cili ka qen i preokupuar se kishte lëndime serioze te cilat do te ishin me pasoja për jetën me vonë. Kjo frike ka zgjatur disa sekonda. Frika sekondare e intensitetit te mesëm ka zgjatur 6 orë, pas kthimit ne shtëpi dhe ditëve ne vijim krahas dhembjeve post pneumatike trupore me shqetësime dhe situata ankthi. Frika e intensitetit te ulët ka zgjatë 60 ditë, qe përjeton sidomos kur kalon aty pari ne vendin e aksidentit ku i bie te kaloje çdo dite për ta drejtuar automjetin e tij.

Duke marre për baze intensitetin dhe kohëzgjatjen e frikës te konstatuar nga eksperti mjekësor e gjykata e aprovoi shumen prej 1300 euro.

Eksperti mjekësor konstatoi se paditësit iu ka dashur ndihma e huaj ne kohëzgjatje prej 14 ditë e cila ka qenë e nevojshme, për aktivizimin nga shtrati dhe kryerjen e funksioneve te përditshme fiziologjike, ne mbajtje te higjienës personale dhe veshmbathje, për këtë formë të demit gjykata e aprovoi shumën prej 150 euro.

Ushqimi i përforcuar i pasur me proteina minerale, vitamina ka qene i nevojshëm për 14 ditë, prandaj gjykata e aprovoi shumen prej 140 euro.

Paditësi E.X. ne aksidentin e komunikacionit sipas vlerësimit te ekspertit mjekësor Dr.N.H. neurolog ka pësuar këto lëndime trupore:.

Gjendje post traumës të kokës, shtypje te kokës, humbje te vetëdijes dhe kokë dhimbje. Natyra e lëndimeve fillimisht ne mendimin dhe konstatimin me shkrim është konstatuar e lehte trupore por eksperti mjekësore ne seancën kryesore me dt.27.11.2023, e ka bere plotësimin e ekspertizës ashtu qe natyrën e lëndimeve trupore të paditësit janë kualifikuar si të rëndë ngase ka zvogëlim te aktivitetit jetësore(ZAJ) në shkallë prej 3%.

Eksperti konstatoi se paditësi ne momentin e aksidentit ka pësuar lëndime si dhe gjate intervenimit mjekësore, gjatë pushimit mjekësor ka pësuar dhimbje fizike. Me intensitet jashtëzakonisht të lartë kanë zgjat 30 minuta dhe janë manifestuar nga momenti i aksidentit derisa paditësi ka arrit ne qendrën emergjente dhe është ordinuar me terapi adekuate për dhimbje. Dhimbjet e intensitetit te larte kanë zgjatur 5 ditë të cilat janë manifestuar si pasoj e lëndimeve ne kokë (shtypje ne regjionin e kokës qe manifestohet me dhimbje te kokës dhe marramendje). Dhembjet e intensitetit te mesëm kanë zgjat 4 jave kohe pas kohe deri ne marrjen e barërave. Dhembjet e intensitetit te lehtë janë kronike prezentë dhe tutje.

Gjykata duke marre për baze natyrën e rëndë të lëndimeve trupore, intensitetin kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike te konstatuar nga eksperti e aprovoi shumen prej 2200 euro.

Paditësi si pasojë e lëndimeve trupore tek i njëjti ka mbetur zvogëlimi i aktivitetit te përgjithshëm jetësore ne shkallen pre 3%, dhe për shkak te këtij zvogëlimi ne raport me ketë shkalle përjeton edhe dhimbje shpirtërore dhe gjykata mbi ketë baze e aprovoi shumen prej 1500 euro.

Paditësi si pasojë e lëndimeve trupore eksperti mjekësore ka konstatuar se është manifestuar frika me këto intensitete:

Frika primare nuk ka ekzistuar pasi qe paditësi ne momentin e aksidentit e ka humbur vetëdijen dhe i njëjti nuk ka ditur për veten derisa ka shkuar ne QE Mitrovicë. Frika sekondare e intensitetit te larte është frika nga momenti i ardhjes se vetëdijes ne QE Mitrovicë ku paditësi shqetësohet për gjendjen ekzistuese si dhe lëndimet e pësuar, kryerjen e ekzaminimeve te nevojshme për diagnostikim si ne laborator rëntgen etj. Kjo frike ka zgjat 48 ore ngase dërgohet ne kliniken e neurologjisë për hospitalizim te mëtejshëm nga dt.21.06.2022 deri me dt.22.06.2020.

Frika sekondare e intensitetit te mesëm ka zgjatur 4 muaj, ku si pasojë e lëndimeve trupore ka dhimbje te shpeshta trupore dhimbje koke, marramendje dhe frikë.

Frika sekondare e intensitetit te ulët është prezentë edhe sot sidomos kur kalon aty pari ne vendin ku ka ndodhur aksidenti, kur drejton vete automjetin apo është si bashke udhëtar ne automjet me dike tjetër.

Duke marre për baze intensitetin dhe kohëzgjatjen e frikës gjykata e aprovoj shumën prej 1500 euro.

Paditësit iu ka dashur ndihma e personit të tretë ne kohëzgjatje prej 20 ditësh e cila ka qene e nevojshme për aktivizim nga shtrati dhe ndihmën e kryerjeve te nevojave dhe funksioneve fiziologjike te përditshme, veshmbathjeve, mbajtje te higjienës personale dhe për ketë gjykata e aprovoj shumen prej 250 euro.

Ushqimi i përforcuar i pasur me proteina minerale dhe vitamina ne raport me ushqimin e rëndomtë ka qenë i nevojshëm prej 20 ditësh me qellim te rikuperimit te shpejte te lëndimeve trupore dhe gjykata për ketë forme te demit e aprovoj shumën prej 200 euro.

Gjykata e vlerësoi ekspertizën mjekësore të dhënë nga ekspertet Dr. N.H. neurolog dhe Dr. G.H. psikiatër te cilave iu dha bindje te plote si prova te besueshme ngase ekspertiza i përmban te gjitha kriteret e nevojshme te dhëna nga ekspertet mbi bazën e njohurive profesionale dhe përmbajnë arsye te mjaftueshme, prandaj gjykata i morri si prova vendimtare mbi bazën e te cilave është konstatuar natyra e lëndimeve trupore dhe format tjera te demit qe i kanë pësuar paditësit ne aksident te komunikacionit.

Pasi qe paditësi E.X. ka pësuar dem material ne automjetin e tij Jeep-Suzuki me targa..., për konstatim të lartësisë së dëmit është nxjerrë ekspertiza e makinerisë nga eksperti S.B.

Eksperti pas analizimit dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, analizimit te aksidentit, demit dhe riparimit të automjetit, analizimit dhe vlerësimit të vlerës se automjetit te dëmtuar dhe vlerësimit te ofertave mesatare për automjetin e dëmtuar, ka ardhur ne përfundim se riparimi i automjetit te dëmtuar “teknikisht dhe ekonomikisht” nuk është i arsyeshëm. Andaj konstatoi se automjeti është “dëm total” dhe duhet te zëvendësohet sipas tabelës se mëparshme. Analiza për demin total: vlera reale e automjetit ne kohen e aksidentit është marre mesatarja nga disa oferta sipas tregut ne Kosove siç është përshkruar ne faqen 3 te ekspertizës.

Eksperti ka vlerësuar se vlera e automjetit ne kohen e aksidentit sipas mesatares ka qene 5,266 euro, ndërsa vlera e pjesëve te mbetura nga demi total i automjetit prej 40 % është zbritur nga shuma totale e vlerësuar e demit dhe vlera e demit material ne kohen e aksidentit është ne shumen prej 3,159.60 euro.

Gjykata e vlerësoi ekspertizën e komunikacionit dhe të makinerisë te dhëna nga eksperti S.B. te cilat gjykata i morri si prova te besueshme ngase eksperti ne mënyrë te drejte ka konstatuar te gjitha rrethanat dhe faktorët qe kanë ndikuar ne shkaktimin e aksidentit te trafikut dhe ka ardhur ne përfundim se i siguruari i te paditurës është shkaktar i vetëm i aksidentit te komunikacionit me dt.20.06 2020 ndërsa paditësi nuk ka dhënë kontribut ne shkaktimin e tij.

Po ashtu ekspertiza e makinerisë është dhënë ne mënyrë te drejte ngase eksperti në mënyrë profesionale duke i përdor të gjitha metodat vlerësuese përcaktuara me ligj dhe praktikat më të avancuara profesionale ka konstatuar lartësinë e demit ne automjetin e paditësit E.X. të cilin mendim gjykata e mori si provë vendimtare.

Pas vërtetimit të faktit se i siguruari i te paditurës është shkaktar i vetëm i aksidentit te komunikacionit gjykata i zbatoi dispozitat e nenit 136 paragrafi 1 te LMD-së ku është përcaktuar “*Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyre ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”. Për sa i përket shpërblimit te demit jo material ne te holla gjykata i zbatoj dispozitat e nenit 183 të LMD-së paragrafi 1 ku shprehimisht është përcaktuar “*Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore për shkak te zvogëlimit te aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit te autoritetit, të nderit, te lirive ose te drejtave te personalitetit, te vdekjes se personit te afërm, si dhe frikës, gjykata, po te konstatoje se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhimbjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do te gjykoje shpërblimin e drejte ne te holla, pavarësisht nga shpërblimi i demit material si dhe nga mungesa e demit material*”.

Gjykata në përputhje me dispozitat e nenit 183 paragrafi 2 sipas detyrës zyrtare, është kujdesur për te mirën e cenuar nga akti dëmtues dhe qëllimit qe i shërben ky shpërblim.

Sa i përket aprovimit te demit material dhe shumat e aprovuara gjykata është bazuar ne mendimin e eksperteve dhe ka vlerësuar se kjo pjese e kërkesëpadisë është e bazuar ne dispozitat e nenit 179 paragrafi 1 i LMD-së dhe dispozitat e nenit 169 par.3 të LMD-së për sa i përket demit total në automjet.

E paditura është obliguar qe paditësve te iu shpërblej demin ne shumat e gjykuara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi ngase me të siguruarin e saj - shkaktarin e aksidentit kanë lidhur kontratën e sigurimit nga (autopergjegjsia) që mbulohet kompensimi i demit palëve të treta në përputhje me dispozitat e nenit 3, 9 të LSDA nr. 04/-018, në baze te fajësisë, prandaj për këto arsye gjykata e detyroi të paditurën për shpërblimin e demit. Shumat e aprovuara për te dy paditësit për te gjitha kategoritë zhdëmtuese janë ne pajtueshmëri te plote me natyrën e lëndimeve trupore dhe format

tjera te demit, prandaj ky shpërblimi paditësve iu shërben si satisfakcion në mënyre qe ti plotësojnë nevojat e tyre me te mira materiale.

Për lartësinë e shumave të aprovuara gjykata ka marrë për baze vlerësimet e eksperteve te fushave përkatëse, praktikat gjyqësore dhe është bazuar ne dispozitat e nenit 323 te LPK-së sipas bindjes se lirë, Udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Kosovës nr.41/2023 të dt.27.02.2023 mbi caktimin e kriterëve orientuese për lartësinë e shpërblimit të demit jo material.

Është refuzuar pjesa e kërkesëpadisë mbi shumat e gjykuara për te gjitha kategoritë zhdëmtuese për të dy paditësit ngase shumat e precizuara me kërkesëpadi janë te larta ne raport me demin e pësuar dhe nuk janë në pajtueshmëri me demin e konstatuar dhe rrjedhimisht nuk do ti shërbenin qëllimit te shpërblimit te demit.

Janë vlerësuar me vëmendje kundërshtimet e palës se paditur me përgjigje ne padi dhe gjate shqyrtimit kryesor por te njëjtat nuk u mbështetën në ndonjë provë dhe nuk është propozuar nxjerrja e ndonjë prove tjetër përveç atyre që nuk u kundërshtuan nga e paditura, prandaj kundërshtimet e pa provuara rezultuan se nuk janë me ndikim që të vendoset ndryshe nga ajo që është vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi qe e paditura është e obliguar që paditësve të iu shpërblejë shpenzimet e procedurës kontestimore ne shumat e specifikuar si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, është i bazuar ne dispozitat e nenit 449, 452 paragrafi 1 te LPK-së.

Vendimi qe e paditura demin jo material ta kompensoj me kamatë ne normën prej 8 % nga dita e marrjes se aktgjykimit me dt. 10.01.2024, ndërsa demin material me kamat prej 8 % nga dita shkaktimit te demit me dt.21.06.2020 është i bazuar ne dispozitat e nenit 382 te LMD-së dhe Mendimit juridik për kamate ligjore te Gjykatës Supreme te Kosovës nr.265/2020 dt.02.12.2020.

Me sa u tha me larte konform dispozitave ligjore materiale te cituara me larte, dhe dispozitave te nenit 143 te LPK-së u vendos ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA NË SKËNDERJ  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM  
C.nr.379/2020 me datë 10.01.2024**

**Gjyqtari,  
Hajrullah Aruqi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 dite, nga dita e marrjes së aktgjykimit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.